



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.23/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtar, duke vendosur lidhur me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës – KDI, kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 07.06. 2026, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 06.06.2026, mori këtë:

VE N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.23/2026, e datës 04.06.2026, e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës – KDI, kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 07.06.2026.

A r s y e t i m

Me datën 04.06.2026, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës – KDI në të cilën pretendohet se me datë 04.06.2026 monitoruesit e organizatës së tyre kanë hasur në vendosje të posterëve/banerëve në hapësira publike në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme që flasin për Kodin e Mirësjelljes së Subjekteve Politike. Tutje, parashtruesi i ankesës thekson se monitoruesit e KDI-së kanë raportuar se në rrugën “Arbënor dhe Astrit Dehari”, në objektin apo pritoren e stacionit të autobusëve të trafikut urban në Prishtinë brenda saj godine është vendosur një baner i madh me fotografinë dhe emrin e kandidatit të PDK-së, Uran Ismajli, prandaj bazuar në këto veprime sipas parashtruesit të ankesës cenojnë nenin 34, par.1, nen par.1.2 ku thuhet se që: “Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”. Andaj, bazuar në provat e bashkangjitura, parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP që ta pranojë këtë ankesë si të bazuar dhe të shqiptojë sanksion të duhur me gjobë.

Si provë në ankesë, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografitë nga vendosja e banerit në pritoren e stacionit të autobusit të kandidatit Uran Ismajli nga subjekti politik PDK.

Në përgjigjen në ankesë, Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) thekson se e kundërshtojnë ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, si të pabazuar. Duke theksuar se Komuna e Prishtinës dhe “Selmans Network SH.P.K” me datë 15.08.2025 kanë lidhur kontratë për “Marrje në menaxhim dhe modernizim të pritoreve të autobusëve në Prishtinë” dhe në të njëjtën kontratë janë vendosur të drejtat e operatorit për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese në pritore për periudhën e kontratës (5 vite). Në këtë kuptim, PDK ka lidhur kontratë me Selmans Network SH.P.K., për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese për periudhën nga data 30 maj 2026 deri me 6 qershor 2026 si dhe përmes kësaj kontratë PDK ka siguruar paraprakisht të drejtën e shfrytëzimit të hapësirave reklamuese për fushatë zgjedhore nga operatori ekonomik që sipas Kontratës me Kryeqytetin, i ka në menaxhim dhe shfrytëzim këto hapësira. Prandaj, materiali reklamues i kontestuar është vendosur në kuadër të një marrëdhënie të rregullt kontraktuale, në panel reklamues të pritores së autobusëve, me lejen e shfrytëzuesit përkatës dhe brenda periudhës së kontraktuar.

Në përgjigje, PDK sqaron gjithashtu se fotografia të cilës i referohet ankuesi mund të dëshmojë vetëm ekzistimin e materialit reklamues në pritoren përkatëse, mirëpo ajo nuk e provon mungesën e lejes ose mungesën e bazës kontraktuale, përkundrazi provat materiale të bashkangjitura kësaj përgjigjeje dëshmojnë së hapësira e kontestuar është hapësirë reklamuese e menaxhuar nga Selmans Network SH.P.K., dhe se PDK ka pasur marrëveshje të vlefshme për shfrytëzimin e saj gjatë periudhës së fushatës. Andaj, PDK kërkon nga PZAP që ta refuzoj si të pabazuar ankesën e paraqitur nga KDI si dhe të konstatoj se vendosja e materialit reklamues të subjektit politik PDK/kandidatit Uran Ismajli është bërë sipas kontratës së datës 30.05.2026 me Selmans Network SH.P.K., operator ekonomik që menaxhon dhe shfrytëzon hapësirat reklamuese në pritoret e autobusëve të Kryeqytetit.

Si provë në përgjigje në ankesë e kanë bashkëngjitur kontratën e lidhur mes Kompanisë “Selmans Network” dhe Kryeqytetit/Komunës së Prishtinës për marrjen në menaxhim, modernizimin dhe mirëmbajtjen e pritoreve të autobusëve të datës 15 Gusht 2025, Kontratën mes subjektit politik PDK dhe kompanisë “Selmans Network” për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese e datës 30 Maj 2026 për periudhën nga 30 Maj 2026 deri me 6 Qershor 2026 si dhe pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Prishtinës, të datës 29.05.2026, për kompaninë Selmans Network.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia- PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore të Institutit Demokratik të Kosovës – KDI dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik PDK, vlerësoj se pretendimet e Institutit Demokratik të Kosovës – KDI , janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e

Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se “Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”

Paneli vlerëson se, në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë nga subjekti politik PDK ka vërtetuar faktin se me datë 30.05.2026 kanë lidhur kontratën mes subjektit politik PDK dhe Kompanisë “Selmans Network” për shfrytëzimin e hapësirave – pritoret e autobusëve ne Prishtine me mundësi reklamuese për subjektin politik PDK në periudhën prej 30.05.2026 deri me 06.06.2026 dhe se kompania “Selmans Network” ka marr Pëlqimin e lëshuar për të nga Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Prishtinës me datë 29.05.2026, për shfrytëzimin e hapësirave publike ne pritoret e autobusëve te qytetit. Pra vendosja e këtyre posterave është në pajtim me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve publike konkretisht nen paragrafi 1.2 “të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo ne hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushate zgjedhore”. Pra, vendosja e tyre- posterëve është në pajtim me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve publike konkretisht nen paragrafi 1.2 “të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo ne hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushate zgjedhore”.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku parashihet që: “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
ZP.Anr.23/2026 më datë 06.06.2026

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.